

**VENDIM**

Nr.838, datë 13.12.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.231, DATË 11.5.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
"PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE PERIUdhËN E PROVËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 17 e vendimit nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"17. Pikët maksimale të mundshme janë:

- a) 70 pikë në rezultatin e testimit;
- b) 10 pikë për përvojën në punë të kandidatit dhe kualifikimet afatshkurtra;
- c) 12 pikë për diplomën master;
- ç) 8 pikë për aftësitë e veçanta personale;
- d) kandidatët me gradë shkencore "Doktor i shkencave" vlerësohen me pikët maksimale të testimit me gojë."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha